

VENDIM
Nr. 634, datë 7.9.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 589, DATË 10.9.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË EVIDENTIMIT FAKTIK NË TERREN TË NDËRTIMEVE PA LEJE/SHTESAVE NË NDËRTIME ME LEJE, TË ORGANEVE DHE DOKUMENTACIONIT PËR PROPOZIMIN DHE MIRATIMIN E ZONAVE INFORMALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 45/1, pika 1, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 589, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Për ushtrimin e të gjitha përgjegjësi të njësive të qeverisjes vendore dhe të këshillave të qarqeve, lidhur me evidentimin në terren të ndërtimeve pa leje, hartimin e dokumentacionit mbi bazën e gjendjes faktike dhe shqyrtimin e miratimit të procedurave të legalizimit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI) zbaton vetëm procedurat e përcaktuara në këtë vendim. Si rregull, evidentimi në terren dhe hartimi i dokumentacionit të gjendjes faktike të objekteve dhe shtesave pa leje, në vijim të quajtura “ndërtime informale”, kryhet nga drejtoritë e varësisë të ALUIZNI-t, sipas njësive strukturore “bllok kadastral”.

Në procedurat e evidentimit dhe hartimit të dokumentacionit të gjendjes faktike të ndërtimeve informale përfshihen:

- a) përditësimi i të dhënave të gjendjes ndërtimore;
- b) plotësimi i procesverbalit të konstatimit, sipas modelit të miratuar me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të ALUIZNI-t;
- c) krijimi i hartës së përditësuar në formatin elektronik dhe *hard copy* dhe hartimi i dokumentacionit teknik (genplan, planimetri).”.

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1 dhe 1/2, me këtë përmbajtje:

“1/1. Kur nga evidentimi në terren, ALUIZNI nuk mund të përcaktojë funksionin e ndërtimit informal, sepse ai është i papërfunduar në vëllim, atëherë poseduesi i ndërtimit duhet të deklarojë destinacionin e përdorimit të tij, nëpërmjet një akti noterial. Në rast të kundërt, funksioni prezumohet se është “social-ekonomik”.

1/2. ALUIZNI nuk është përgjegjës, në asnjë rast, për ndryshimet e gjendjes ndërtimore apo të funksionit të ndërtimit informal, të realizuara pas evidentimit në terren (plotësimit të procesverbalit të konstatimit).”.

3. Në pikën 2, fjalët “... sipas pikave 1 dhe 2 ...” zëvendësohen me “... sipas pikës 1...”.

4. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

“3/1. Kur nuk është plotësuar deklarata për përfshirje sipas pikës 2, të këtij vendimi, subjekti posedues i ndërtimit informal mund të paraqesë kërkesë pranë ALUIZNI-t. Në këtë rast, drejtoritë e ALUIZNI-t kryejnë paraprakisht verifikimet sipas pikës 3 të këtij vendimi, dhe nëse rezulton se ndërtimi është i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, të ndryshuar, poseduesit i jepet mundësia për të plotësuar deklaratën për përfshirje.”.

5. Në pikën 6, fjala “instrumenteve” zëvendësohet me “dokumenteve”.

6. Kudo në vendim, emërtimet “Ministri i Zhvillimit Urban dhe Turizmit” dhe “Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit” zëvendësohen përkatësisht me “Ministri i Zhvillimit Urban” dhe “Ministria e Zhvillimit Urban”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama